



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Shk.Shk.II.nr.108/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ-komercial sipas padisë së paditësit NPN D... me seli në Prishtinë rr..... nr..., e përfaqësuar nga Adelina Hoxha avokate nga Prishtina kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Erlehta Popaj me autorizim, me bazë juridike, anulim i Konkluzionit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.887/2016 të datës 09.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.10.2022 merr:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditues Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë e datës 13.02.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.887/2016 i datës 09.01.2020 VËRTETOHET.

### A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit NPN D... me seli në Prishtinë, ndërsa ka anuluar Konkluzionin e të paditues Organi Shqyrtues i Prokurimit p.sh.nr.23/16 i dt.24.405.2016, dhe qështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor e paditura ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar, Aktgjykimin e atakuar ta anuloj si të pabazuar si dhe të refuzohet padia dhe kërkespadia e paditësit si e pabazuar. Paneli shqyrtues vendimin e ka marrë konform mendimit të ekspertit shqyrtues i cili ka konstatuar se konform rregullores së OSHP-së neni 18.1 ankesa konsiderohet si qështje e gjykuar pasi që pretendimet ankimore janë shqyrtuar edhe me datën 24.12.2015 në vendimin 502/15. OSHP sqaron se edhe pse kemi të bëjmë me dy operator ekonomik ankues të ndryshëm, pretendimet ankimore janë të njëjta dhe ato janë shqyrtuar me një vendim paraprak dhe për këtë arsye kjo është konsideruar si qështje e gjykuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit në kundërshtimin në ankesë datë 12.05.2020 kërkon që gjykata ta refuzoj ankesën e të paditues dhe të aprovoi si të bazuar Aktgjykimin A.nr.887/2016. Shkeljet evidente të vërtetuara në aktgjykim janë të sakta sepse në asnjë moment i padituri nuk është marë me pretendimet e paditësit por apriori ka vendosur duke mos shqyrtuar ankesën e paditësit fare. E drejta materiale është aplikuar drejtë sepse gjykata

nuk ka obligim të lëshohet në vlerësimin e ekspertëve përderisa ekzistojnë shkeljet esenciale të LPA-së, dhe atë nga neni 84 dhe 85.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, shqyrtoi ankesën e paditurës, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe neni 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me Konkluzionin P.SH.23/2016 dt.18.05.2016, ka Hudhur Poshtë si të palejuar ankesën e O.E. D... e dt.03.02.2016 lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirmbajtja dimërore e rrugëve rurale-pastrimi i rrugëve nga bora me nr.prokurimi 616-15-231-521 të inicuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi me padi inicon konflikt administrativ në Gjykatën e shkallës së parë, e cila në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor më datë 09.01.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor merr Aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit NPN D... me seli në Prishtinë, ndërsa ka Anuluar Konkluzionin e të paditues Organi Shqyrtues i Prokurimit p.sh.nr.23/16 i dt.24.405.2016, dhe qështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Në arsyetim ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka theksuar se; e paditura gabimisht e ka konstatuar qështjen e paditësit res judikata pa u lëshuar fare në shqyrtim të pretendimeve ankimore të tij. Krejt kjo për arsye se një qështje e gjykuar mund të konsiderohet vetëm atëher kur për të njëjten qështje është vendosur me aktgjykim të formës së prerë. Gjykata e shkallës së parë ka obliguar të paditoren që në rivendosje të veproj sipas vërejtjeve në aktgjykim.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në bazë të ankesës së paditues dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj.

Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë si dhe shkresave të tjera të lëndës si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me aprovimin e kërkesë padisë së paditësit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Konkluzioni i atakuar i të paditues OSHP-së, përmban të meta të cilat konsistojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 84, 85, të të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, nuk është vërtetuar gjendja faktike lidhur me pretendimet ankimore gjatë procedimit administrativ nga e paditura, me qka konstatohet se është cënuar ligji në dëm të paditësit me refuzimin e ankesës së tij.

Në raport me pretendimet e paditues në ankesë se ankesa e paditësit konsiderohet si qështje e gjykuar pasi që pretendimet ankimore janë shyrtuar edhe me datën 24.12.2015 në vendimin ..... OSHP-së, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë e refuzoi si të pa bazuara për faktin se Vendimi PSH nr.... date 23.12.2015 i OSHP-së, ka të bëjë me një subjekt tjetër ankues në procedurën administrative të ankesave, dhe është e papranueshme të konsiderohet si qështje e gjykuar, një rast tjetër kur vendoset për pretendime të njëjta ankimore.

Ligji nr.2/L-28 për Procedurën Administrative, që ka qenë në fuqi me rastin e vendosjes në procedurën administrative, neni 11 parasheh: Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë, Obligim ligjor të cilin në këtë rast e ka pasur e paditura të vendos sipas ankesës së paditësit, mirëpo e njëjta nxjerr aktin administrativ-Konkluzion, duke e trajtuar në mënyrë jo të ligjshme ankesën e paditësit, duke e Hedhur poshtë si të palejueshme.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Dhoma e Shkallës së Dytë i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe fakteve të ofruara nga paditësi dhe e paditura, si dhe ka bërë elaborimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 44 të LKA-së.

Duke shqyrtuar lëndën edhe sipas detyrës zyrtare, kjo gjykat gjen se procedura në gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar ashtu siç parashihet me ligj, ku janë nxjerrë prova të mjaftueshme për vendosjen e drejtë të çështjes.

Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.108/2022 me datë 27.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Krenar Berisha